

Njoftim për përqendrim me të cilin CROATIA osiguranje d.d., Zagreb, Republika e Kroacisë dhe AV International GmbH, Vjenë, Austri, synojnë të themelojnë një sipërmarrje të përbashkët në bazë të së cilës do të krijohet një shoqëri e përbashkët (lënda nr. 08-111/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 15.07.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin CROATIA osiguranje d.d., me seli në rr. Vatroslava Jagića nr. 33, Zagreb, Republika e Kroacisë dhe AV International GmbH, me seli në Muthgasse 27, 1190 Vjenë, Austri, kanë lidhur Marrëveshje për sipërmarrje të përbashkët në bazë të së cilës do të themelohet një shoqëri e përbashkët.

Shoqëria e sapo themeluar do të jetë nën kontrollin e përbashkët të CROATIA osiguranje d.d. dhe AV International GmbH, dhe do të funksionojë si një subjekt i pavarur ekonomik. Objekti i përqendrimit është fitimi i kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë e sapo themeluar.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

CROATIA osiguranje d.d. është një shoqëri tregtare e themeluar dhe që vepron në përputhje me rregulloret e Republikës së Kroacisë. Veprimtaria kryesore e pjesëmarrësit CROATIA osiguranje d.d. është sigurimi dhe risigurimi.

Për më tepër, përmes ndërmarrjeve në pronësi të CROATIA osiguranje d.d. (në tekstin e mëtejshëm "Grupi CROATIA"), në tregun gjeografik në R. e Kroacisë por edhe në R. e Sllovenisë, Bosnjë e Hercegovinë dhe R.V. të Maqedonisë, përveç punëve të sigurimit dhe risigurimit, kryejnë edhe këto veprimtari: menaxhimin e fondeve pensionale, kryerjen e kontrolleve teknike të automjeteve, ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe punët me pasuri të paluajtshme.

CROATIA osiguranje d.d. është në pronësi të shumicës të shoqërisë ADRIS GRUPA d.d., me seli në Rovinj, Obala V. Nazora 1, NUAS: 82023167977 (në tekstin e mëtejshëm "ADRIS GRUPA d.d.") veprimtaria kryesore e së cilës është menaxhimi dhe investimi, përmes së cilës është e pranishme në tregun e turizmit, prodhimit të ushqimit të shëndetshëm, sigurimeve dhe energjetikës.

Në tregun gjeografik përkatës të R.M.V-së, CROATIA osiguranje d.d. është e pranishme në tregun e sigurimeve, përmes dy ndërmarrjeve të saj të lidhura mbi të cilat ushtron kontroll të drejtpërdrejtë, dhe atë:

- CROATIA SIGURIMI SHA Shkup – shoqëri për sigurimin e jetës Shkup – rr. Zheleznička nr. 41, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, në të cilën zotëron 95% të aksioneve;
- CROATIA SIGURIMI SHA Shkup – Shoqëri për sigurim jo të jetës Shkup – rr. Zheleznička nr. 41, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, në të cilën zotëron 100% të aksioneve.

AV International GmbH është një shoqëri tregtare e themeluar dhe që vepron sipas rregulloreve të Republikës së Austrisë, e cila vepron si një kompani ndërkombëtare holding dhe shërbimi në kuadër të grupit AVAG Holding SE (në tekstin e mëtejshëm: "AVAG").

AVAG është një nga grupet kryesore tregtare të automobilave në Evropë, me theks në koordinimin dhe mbështetjen administrative të rrjetit të salloneve të automobilave jashtë Gjermanisë.

AV International GmbH është nën kontrollin e drejtpërdrejtë dhe në pronësi 100% të AV Holding International e cila, nga ana tjetër, është nën kontrollin e drejtpërdrejtë dhe në pronësi 100% të AVAG. AV International GmbH menaxhon aktivitetet ndërkombëtare të AVAG përmes një rrjeti ndërmarrjesh nën kontroll të shumicës në Austri, Kroaci, Slloveni dhe Hungari.

AV International GmbH nuk është e pranishme dhe nuk ka shoqëri të lidhura në tregun gjeografik në RMV.

Si pasqyrimi i parashtrimit të njoftimit, tregu përkatës për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si treg për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve motorike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

17.07.2026

Shkup